

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRAN

02 Nr./br. 149/18

Nr. i Ep./Dit. sh.

Data: / Datum 02.02.2018

VUSHTRRI - VUÇITRAN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 “ f” dhe “g” të Statutit të Komunës, nenin 21 të Rregullores së MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 8 të Rregullës Financiare për Menaxhimin e Pasurisë Financiare të Komunës dt.464/14, dt. 20.03.2014, si dhe me propozim të Drejtorit për Buxhet dhe financa, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR VLERËSIM TË PASURISË JO FINANCIARE TË
KOMUNËS

1. Me këtë vendim formohet Komisioni për vlerësim të Pasurisë jo Financiare të Komunës në këtë përbërje:
 - 1.1 **Sabile Klinaku**, kryesuese e komisionit
 - 1.2 **Lindita Haradinaj**, anëtare
 - 1.3 **Remzije Zekolli**, anëtare
2. Komisioni nga pika paraprake e këtij vendimi do të kryej detyrat e tij në pajtim me nenin 21 pika 4 të Rregullores së MF – Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe nenin 9 të Rregullës financiare për Menaxhim të pasurisë jo financiare të komunës dt.464/14, dt. 20.03.2014.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi ju dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në pikën "b" të nenit 5 të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M PËR FORMIM TË GRUPIT PUNUES

1. Formohet grupi punues për bashkërendim të aktiviteteve në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe GIZ-it për realizim të pilot projektit për menaxhimin e mbeturinave të ngurta.
2. Grupi punues ka këtë përbërje:
 - 2.1 Islam Latifi, koordinator
 - 2.2 Bajram Beqiri, anëtar
 - 2.3 Fortuna Krasniqi, anëtar
 - 2.4 Egzon Haradinaj, anëtar
 - 2.5 Idriz Ismajli, anëtar
 - 2.6 Abit Abiti, anëtar
 - 2.7 Blerim Zhabari, anëtar
 - 2.8 Haki Shabani, anëtar
3. Grupi punues do të jetë përgjegjës për çështjet që janë të përfshira në Memorandum të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), nr. 883/17, dt. 31.07.2017.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 991/17, dt.28.08.2017.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi ju dërgohet: Anëtarëve të grupit punues dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës
Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRI - OPSTINA VUSHTRRI

02.Nr./Dr. 160 / 18

Nr. i fq./Besi

Data / Datum 07.02.2018

VUSHTRRI - VUSHTRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 “f” dhe “g” të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nr.4473/18, dt. 01.02.2018 dhe Drejtorit për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë nr.25/18, datë 01.02.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për pranim dorëzim të objektit të ish Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtri, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ramiz Maliqi, DUMM
 - 1.2. Ilirijana Azemi, DUMM
 - 1.3. Ajet Gërxhaliu, DGJKP
2. Komisioni në përbërje të cekur në pikën paraprake do të asistoj në procesin e pranim – dorëzimit të objektit të ish Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega në Vushtri me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në ditën në të cilën do të bëhet ky pranim dorëzim.
3. Komisioni me këtë rast pranim dorëzimin do ta bëj me procesverbal të cilin do ta nënshkruajnë anëtarët e komisionit nga komuna si dhe zyrtarët e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës të caktuar për pranim – dorëzim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRË

02 Nr. / Br. 167/18

Nr. i fq. / En. et _____

Data: / Datum 09.02.2018

VUSHTRRI - VUČITRË



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 27 pika 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, dhe nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËR RIINTEGRIM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

1. Formohet komisioni për riintegrim të personave të riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Sylejman Meholli** (Drejtor për shëndetësi dhe përkujdesje sociale) - kryesues
 - 1.2 **Agim Miftari** (zyrtar për arsim) – anëtar
 - 1.3 **Remzije Zekolli** (zyrtare për të drejtat e njeriut) anëtar
 - 1.4 **Ramiz Bunjaku** (zyrtar në qendrën për punë sociale) anëtar
 - 1.5 **Mentor Jashari** (zyrtar për shërbime publike) anëtar
 - 1.6 **Ahmet Shuku** (zyrtar për urbanizëm) anëtar
 - 1.7 **Ilmi Zeqiri** (zyrtar për gjeodezi dhe kadastër) anëtar
 - 1.8 **Gazmend Morina** (zyrtar për integritime evropiane) anëtar
 - 1.9 **Ekrem Merovci** (zyrtar për riintegrim) anëtar
 - 1.10 **Fisnik Leku**, (koordinator rajonal për riintegrim) – anëtar
11. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë konform nenit 27 pika 4-9 të Rregullores (QRK) Nr. 13/2017 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë.
12. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
13. Me këtë vendim njoftohen: anëtarët e komisionit Zyra për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar, në kuadër të MPB të Republikës së Kosovës si dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhaver Tahiri
Xhaver Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИ

U. Nr./U. 176/18
Nr. Tq./Nr. -02-
Data/ Datum 13.02.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, raportin 08nr.03/18 datë 05.01.2018 dhe konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 të organit mbikëqyrës për mbikëqyrje të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të përbashkëta të përkohshme montazhë (5 – pesë njësi) në ngastrën kadastrale P-256-0, në Vushtri, si dhe duke iu referuar nenit 8 pika 1 nënpika 1.1 në lidhje me nenin 3 pika 2 të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër, nr.06/2017, nr.prot. 1395/17 datë 14.12.2017 si dhe bazuar në njoftimin me shkrim të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, Kryetari i Komunës me datën 13.02.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR SHKËPUTJE TË PARAKOHSHME TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE AFATSHKURTËR

1. Me këtë vendim, shkëputet para kohe për të cilën është lidhë kontrata për qiradhënie afatshkurtër nr.06/2017, nr.prot. 1395/17, datë 14.12.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrisë në cilësi të qiradhënësit dhe z. Nisret Hoxha nga Vushtria, Rr. "Zymer Haziri", në cilësi të qiramarrësit, për shkak të dështimit të qiramarrësit për të përmbushur këtë kontratë.
2. Z. Nisret Hoxha nga Vushtria urdhërohet që të mos ketë qasje në hapësirën e cila është lëndë e kontratës nr.06/2017, nr.prot. 1395/17, datë 14.12.2017, pronë komunale e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Vushtrisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Qiramarrësit, Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyrtares për Menaxhimin e Pronës komunale në DUMM, dhe Arkivit të Sekretarisë.

Arsyetim

Komuna e Vushtrisë në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Bajram Mulaku, me datën 14.12.2017 ka lidhë kontratë për qiradhënie afatshkurtër me z. Nisret Hoxha nga Vushtria në cilësi të qiramarrësit, (kontrata nr.06/2017, nr.prot. 1395/17, datë 14.12.2017) me të cilën të njëjti ia ka dhënë në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) vitesh, pronën e paluajtshme

komunale, në rr. "Tirana" në Vushtrri njësia kadastrale P-256-0, ZK-Ie Vushtrri lokali nr. 10, në sipërfaqe prej 6.00 m², me qëllim të ndërtimit (nga qiramarrësi) të një objekti tregtie/shërbimi (të tipit kioskë) me etazhitet P+0, me konstrukcion montazhë të lehtë të tipit **Bërvnar**, nga druri i përpunuar i klasit të parë, nga bredhi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtrri.

Me datën 05.01.2018, menaxherja e kontratave të pronës komunale përmes shkresës 08nr.02, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës informatë me shkrim për të konstatuar nëse qiramarrësi ka filluar punimet në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim siç është përcaktuar në kontratë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës në raportin e tij (raporti 08nr.03/18 datë 05.01.2018) ka konstatuar se qiramarrësi nuk ka filluar punët në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim. Organi mbikëqyrës gjithashtu me konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 për herë të dytë ka bërë shikimin në vend dhe ka konstatuar se pala nuk iu ka përmbajtur nenit 3 pika 2 të kontratës në fjalë që donë të thotë se nuk ka filluar punët siç ka qenë i obliguar me kontratë.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithashtu përmes shkresës 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, ka njoftuar se qiramarrësi deri me datën 13.02.2018 nuk ka ndërmarr asnjë veprim përpara i përket paraqitjes së kërkesës për marrje të lejes të përkohshme ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm të paraparë e kontratë.

Në nenin 3 pika 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se: "Afati i fillimit të investimeve konform projektit të aprovuar është jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës".

Poashtu, në nenin 8 të kontratës "Dështimi për të përmbushur kontratën" përkatësisht pikën 1 nënpika 1.1 është saktësuar se kontrata konsiderohet e dështuar nëse qiramarrësi dështon që të i përmbushë kushtet e kësaj kontrate, e që në rastin konkret një ndër kushtet për përmbushje të kontratës është fillimi i realizimit të investimeve jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.

Bazuar në faktin se qiramarrësi edhe pas 59 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës nuk ka bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe brenda këtij afati nuk ka treguar interesim para organit kompetent të komunës për fillim të implementimit të kontratës për qiradhënie afatshkurtër me çka nuk i ka përmbushur obligimet e përcaktuara me kontratë përkatësisht ka dështuar për ta përmbushur kontratën siç precizohet në nenin 8 pika 1 nënpika 1.1, të së njëjtës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUŠTRRI
02 Nr./Dr. 177/18
Nr./Bil. -02-
Datë/Date: 13.02.2018
VUSHTRRI - VUŠTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, raportin 08nr.03/18 datë 05.01.2018 dhe konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 të organit mbikëqyrës për mbikëqyrje të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të përbashkëta të përkohshme montazhë (5 – pesë njësi) në ngastrën kadastrale P-256-0, në Vushtri, si dhe duke iu referuar nenit 8 pika 1 nënpika 1.1 në lidhje me nenin 3 pika 2 të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër, nr.06/2017, nr.prot. 1397/17 datë 14.12.2017 si dhe bazuar në njoftimin me shkrim të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, Kryetari i Komunës me datën 13.02.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR SHKËPUTJE TË PARAKOHSHME TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE
AFATSHKURTËR

1. Me këtë vendim, shkëputet para kohe për të cilën është lidhë kontrata për qiradhënie afatshkurtër nr.06/2017, nr.prot. 1397/17, datë 14.12.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrrisë në cilësi të qiradhënësit dhe z. Femzi Veseli nga Vushtrria, Rr. "Jeton Tërrstena", në cilësi të qiramarrësit, për shkak të dështimit të qiramarrësit për të përmbushur këtë kontratë.
2. Z. Femzi Veseli nga Vushtrria urdhërohet që të mos ketë qasje në hapësirën e cila është lëndë e kontratës nr.06/2017, nr.prot. 1397/17, datë 14.12.2017, pronë komunale e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Vushtrrisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Qiramarrësit, Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyrtares për Menaxhimin e Pronës komunale në DUMM, dhe Arkivit të Sekretarisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Bajram Mulaku, me datën 14.12.2017 ka lidhë kontratë për qiradhënie afatshkurtër me z. Femzi Veseli nga Vushtrria në cilësi të qiramarrësit, (kontrata nr.06/2017, nr.prot. 1397/17, datë 14.12.2017) me

të cilën të njëjtit ia ka dhënë në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) vitesh, pronën e paluajtshme komunale, në rr. "Tirana" në Vushtrri njësia kadastrale P-256-0, ZK-le Vushtrri lokali nr. 8, në sipërfaqe prej 9.00 m², me qëllim të ndërtimit (nga qiramarrësi) të një objekti tregtie/shërbimi (të tipit kioskë) me etazhitet P+0, me konstrukcion montazhë të lehtë të tipit **Bërvnar**, nga druri i përpunuar i klasit të parë, nga bredhi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtrri.

Me datën 05.01.2018, menaxherja e kontratave të pronës komunale përmes shkresës 08nr.02, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës informatë me shkrim për të konstatuar nëse qiramarrësi ka filluar punimet në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim siç është përcaktuar në kontratë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës në raportin e tij (raporti 08nr.03/18 datë 05.01.2018) ka konstatuar se qiramarrësi nuk ka filluar punët në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim. Organi mbikëqyrës gjithashtu me konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 për herë të dytë ka bërë shikimin në vend dhe ka konstatuar se pala nuk iu ka përmbajtur nenit 3 pika 2 të kontratës në fjalë që donë të thotë se nuk ka filluar punët siç ka qenë i obliguar me kontratë.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithashtu përmes shkresës 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, ka njoftuar se qiramarrësi deri me datën 13.02.2018 nuk ka ndërmarr asnjë veprim përsa i përket paraqitjes së kërkesës për marrje të lejes të përkohshme ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm të paraparë e kontratë.

Në nenin 3 pika 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se: "Afati i fillimit të investimeve konform projektit të aprovuar është jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës".

Poashtu, në nenin 8 të kontratës "Dështimi për të përmbushur kontratën" përkatësisht pikën 1 nënpika 1.1 është saktësuar se kontrata konsiderohet e dështuar nëse qiramarrësi dështon që të i përmbushë kushtet e kësaj kontrate, e që në rastin konkret një ndër kushtet për përmbushje të kontratës është fillimi i realizimit të investimeve jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.

Bazuar në faktin se qiramarrësi edhe pas 59 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës nuk ka bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe brenda këtij afati nuk ka treguar interesim para organit kompetent të komunës për fillim të implementimit të kontratës për qiradhënie afatshkurtër me çka nuk i ka përmbushë obligimet e përcaktuara me kontratë përkatësisht ka dështuar për ta përmbushur kontratën siç precizohet në nenin 8 pika 1 nënpika 1.1 të së njëjtës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVË
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИ

02 Na / Br 178 / 18
No / Tip / Ushq -02-
Data / Datim 13.02.2018
VUSHTRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, “g” të Statutit të Komunës, raportin 08nr.03/18 datë 05.01.2018 dhe konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 të organit mbikëqyrës për mbikëqyrje të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të përbashkëta të përkohshme montazhë (5 – pesë njësi) në ngastrën kadastrale P-256-0, në Vushtri, si dhe duke iu referuar nenit 8 pika 1 nënpika 1.1 në lidhje me nenin 3 pika 2 të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër, nr.06/2017, nr.prot. 1396/17 datë 14.12.2017 si dhe bazuar në njoftimin me shkrim të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, Kryetari i Komunës me datën 13.02.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR SHKËPUTJE TË PARAKOHSHME TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE
AFATSHKURTËR

1. Me këtë vendim, shkëputet para kohe për të cilën është lidhë kontrata për qiradhënie afatshkurtër nr.06/2017, nr.prot. 1396/17, datë 14.12.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrisë në cilësi të qiradhënësit dhe z. Fisnik Ukshini nga Vushtria, Rr. “Vesli Klark” në cilësi të qiramarrësit, për shkak të dështimit të qiramarrësit për të përmbushur këtë kontratë.
2. Z. Fisnik Ukshini nga Vushtria urdhërohet që të mos ketë qasje në hapësirën e cila është lëndë e kontratës nr.06/2017, nr.prot. 1396/17, datë 14.12.2017, pronë komunale e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Vushtrisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Qiramarrësit, Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyrtares për Menaxhimin e Pronës komunale në DUMM, dhe Arkivit të Sekretarisë.

Arsyetim

Komuna e Vushtrisë në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Bajram Mulaku, me datën 14.12.2017 ka lidhë kontratë për qiradhënie afatshkurtër me z. Fisnik Ukshini

nga Vushtrria në cilësi të qiramarrësit, (kontrata nr.06/2017, nr.prot. 1396/17, datë 14.12.2017) me të cilën të njëjtit ia ka dhënë në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) vitesh, pronën e paluajtshme komunale, në rr. "Tirana" në Vushtrri njësia kadastrale P-256-0, ZK-le Vushtrri lokali nr. 9, në sipërfaqe prej 9.00 m², me qëllim të ndërtimit (nga qiramarrësi) të një objekti tregtie/shërbimi (të tipit kioskë) me etazhitet P+0, me konstrukcion montazhë të lehtë të tipit **Bërvnar**, nga druri i përpunuar i klasit të parë, nga bredhi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtrri.

Me datën 05.01.2018, menaxherja e kontratave të pronës komunale përmes shkresës 08nr.02, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës informatë me shkrim për të konstatuar nëse qiramarrësi ka filluar punimet në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim siç është përcaktuar në kontratë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës në raportin e tij (raporti 08nr.03/18 datë 05.01.2018) ka konstatuar se qiramarrësi nuk ka filluar punët në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim. Organi mbikëqyrës gjithashtu me konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 për herë të dytë ka bërë shikimin në vend dhe ka konstatuar se pala nuk iu ka përmbajtur nenit 3 pika 2 të kontratës në fjalë që donë të thotë se nuk ka filluar punët siç ka qenë i obliguar me kontratë.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithashtu përmes shkresës 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, ka njoftuar se qiramarrësi deri me datën 13.02.2018 nuk ka ndërmarr asnjë veprim përpara i përket paraqitjes së kërkesës për marrje të lejes të përkohshme ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm të paraparë e kontratë.

Në nenin 3 pika 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se: "Afati i fillimit të investimeve konform projektit të aprovuar është jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës".

Poashtu, në nenin 8 të kontratës "Dështimi për të përmbushur kontratën" përkatësisht pikën 1 nënpika 1.1 është saktësuar se kontrata konsiderohet e dështuar nëse qiramarrësi dështon që të i përmbushë kushtet e kësaj kontrate, e që në rastin konkret një ndër kushtet për përmbushje të kontratës është fillimi i realizimit të investimeve jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.

Bazuar në faktin se qiramarrësi edhe pas 59 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës nuk ka bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe brenda këtij afati nuk ka treguar interesim para organit kompetent të komunës për fillim të implementimit të kontratës për qiradhënie afatshkurtër me çka nuk i ka përmbushë obligimet e përcaktuara me kontratë përkatësisht ka dështuar për ta përmbushur kontratën siç precizohet në nenin 8 pika 1 nënpika 1.1, të së njëjtës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИ

OZ No./Br 179/18

Nr. i fsh./Bl. nr -02-

Data / Datum 13.02.2018

VUSHTRRI - ВУШТРИ



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, raportin 08nr.03/18 datë 05.01.2018 dhe konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 të organit mbikëqyrës për mbikëqyrje të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të përbashkëta të përkohshme montazhë (5 – pesë njësi) në ngastrën kadastrale P-256-0, në Vushtri, si dhe duke iu referuar nenit 8 pika 1 nënpika 1.1 në lidhje me nenin 3 pika 2 të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër, nr.06/2017, nr.prot. 1393/17 datë 14.12.2017 si dhe bazuar në njoftimin me shkrim të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, Kryetari i Komunës me datën 13.02.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR SHKËPUTJE TË PARAKOZHME TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE
AFATSHKURTËR

1. Me këtë vendim, shkëputet para kohe për të cilën është lidhë kontrata për qiradhënie afatshkurtër nr.06/2017, nr.prot. 1393/17, datë 14.12.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrisë në cilësi të qiradhënësit dhe z. Mentor Salihu nga fsh. Druar, Komuna e Vushtrisë, në cilësi të qiramarrësit, për shkak të dështimit të qiramarrësit për të përmbushur këtë kontratë.
2. Z. Mentor Salihu nga Druari urdhërohet që të mos ketë qasje në hapësirën e cila është lëndë e kontratës nr.06/2017, nr.prot. 1393/17, datë 14.12.2017, pronë komunale e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Vushtrisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Qiramarrësit, Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyrtares për Menaxhimin e Pronës komunale në DUMM, dhe Arkivit të Sekretarisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrisë në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Bajram Mulaku, me datën 14.12.2017 ka lidhë kontratë për qiradhënie afatshkurtër me z. Mentor Salihu nga Vushtria në cilësi të qiramarrësit, (kontrata nr.06/2017, nr.prot. 1393/17, datë 14.12.2017) me

të cilën të njëjtit ia ka dhënë në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) vitesh, pronën e paluajjtshme komunale, në rr. "Tirana" në Vushtrri njësia kadastrale P-256-0, ZK-le Vushtrri lokali nr. 7, në sipërfaqe prej 9.00 m², me qëllim të ndërtimit (nga qiramarrësi) të një objekti tregtie/shërbimi (të tipit kioskë) me etazhitet P+0, me konstrukcion montazhë të lehtë të tipit **Bërvnar**, nga druri i përpunuar i klasit të parë, nga bredhi, sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtrri.

Me datën 05.01.2018, menaxherja e kontratave të pronës komunale përmes shkresës 08nr.02, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës informatë me shkrim për të konstatuar nëse qiramarrësi ka filluar punimet në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim siç është përcaktuar në kontratë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës në raportin e tij (raporti 08nr.03/18 datë 05.01.2018) ka konstatuar se qiramarrësi nuk ka filluar punët në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim. Organi mbikëqyrës gjithashtu me konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 për herë të dytë ka bërë shikimin në vend dhe ka konstatuar se pala nuk iu ka përmbajtur nenit 3 pika 2 të kontratës në fjalë që donë të thotë se nuk ka filluar punët siç ka qenë i obliguar me kontratë.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithashtu përmes shkresës 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, ka njoftuar se qiramarrësi deri me datën 13.02.2018 nuk ka ndërmarr asnjë veprim përsa i përket paraqitjes së kërkesës për marrje të lejes të përkohshme ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm të paraparë e kontratë.

Në nenin 3 pika 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se: "Afati i fillimit të investimeve konform projektit të aprovuar është jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës".

Poashtu, në nenin 8 të kontratës "Dështimi për të përmbushur kontratën" përkatësisht pikën 1 nënpika 1.1 është saktësuar se kontrata konsiderohet e dështuar nëse qiramarrësi dështon që të i përmbushë kushtet e kësaj kontrate, e që në rastin konkret një ndër kushtet për përmbushje të kontratës është fillimi i realizimit të investimeve jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.

Bazuar në faktin se qiramarrësi edhe pas 59 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës nuk ka bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe brenda këtij afati nuk ka treguar interesim para organit kompetent të komunës për fillim të implementimit të kontratës për qiradhënie afatshkurtër me çka nuk i ka përmbushë obligimet e përcaktuara me kontratë përkatësisht ka dështuar për ta përmbushur kontratën siç precizohet në nenin 8 pika 1 nënpika 1.1, të së njëjtës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

 Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
02 Nr. / Nr.	180/18
Nr. llog. / Sh. nr.	-02-
Data / Data	13.02.2018
VUSHTRRI - VUČITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, raportin 08nr.03/18 datë 05.01.2018 dhe konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 të organit mbikëqyrës për mbikëqyrje të realizimit të projektit për ndërtimin e objekteve të përbashkëta të përkohshme montazhë (5 – pesë njësi) në ngastrën kadastrale P-256-0, në Vushtrri, si dhe duke iu referuar nenit 8 pika 1 nënpika 1.1 në lidhje me nenin 3 pika 2 të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër, nr.06/2017, nr.prot. 1394/17 datë 14.12.2017 si dhe bazuar në njoftimin me shkrim të Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, Kryetari i Komunës me datën 13.02.2018 merr këtë:

V E N D I M
PËR SHKËPUTJE TË PARAKOHSHME TË KONTRATËS PËR QIRADHËNIE
AFATSHKURTËR

1. Me këtë vendim, shkëputet para kohe për të cilën është lidhë kontrata për qiradhënie afatshkurtër nr.06/2017, nr.prot. 1394/17, datë 14.12.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Vushtrrisë në cilësi të qiradhënësit dhe z. Mentor Salihu nga fsh. Druar, Komuna e Vushtrrisë, në cilësi të qiramarrësit, për shkak të dështimit të qiramarrësit për të përmbushur këtë kontratë.
2. Z. Mentor Salihu nga Druari urdhërohet që të mos ketë qasje në hapësirën e cila është lëndë e kontratës nr.06/2017, nr.prot. 1394/17, datë 14.12.2017, pronë komunale e cila i ishte dhënë në shfrytëzim nga Komuna e Vushtrrisë.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Qiramarrësit, Drejtorit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Zyrtares për Menaxhimin e Pronës komunale në DUMM, dhe Arkivit të Sekretarisë.

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e qiradhënësit përfaqësuar nga kryetari i komunës z. Bajram Mulaku, me datën 14.12.2017 ka lidhë kontratë për qiradhënie afatshkurtër me z. Mentor Salihu nga Vushtrria në cilësi të qiramarrësit, (kontrata nr.06/2017, nr.prot. 1394/17, datë 14.12.2017) me

të cilën të njëjtit ia ka dhënë në shfrytëzim në afat prej 5 (pesë) vitesh, pronën e paluajtshme komunale, në rr. "Tirana" në Vushtrri njësia kadastrale P-256-0, ZK-Ie Vushtrri lokali nr. 6, në sipërfaqe prej 9.00 m², me qëllim të ndërtimit (nga qiramarrësi) të një objekti tregtie/shërbimi (të tipit kioskë) me etazhitet P+0, me konstrukcion montazhë të lehtë të tipit **Bërvnar**, nga druri i përpunuar i klasit të parë, nga bredhi, sipas kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Vushtrri.

Me datën 05.01.2018, menaxherja e kontratave të pronës komunale përmes shkresës 08nr.02, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës informatë me shkrim për të konstatuar nëse qiramarrësi ka filluar punimet në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim siç është përcaktuar në kontratë.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës në raportin e tij (raporti 08nr.03/18 datë 05.01.2018) ka konstatuar se qiramarrësi nuk ka filluar punët në hapësirën e cila i është dhënë në shfrytëzim. Organi mbikëqyrës gjithashtu me konkluzionin 08nr.09/18 datë 12.01.2018 për herë të dytë ka bërë shikimin në vend dhe ka konstatuar se pala nuk iu ka përmbajtur nenit 3 pika 2 të kontratës në fjalë që donë të thotë se nuk ka filluar punët siç ka qenë i obliguar me kontratë.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjithashtu përmes shkresës 08 nr.61, nr. prot. 6425/18, dt. 13.02.2018, ka njoftuar se qiramarrësi deri me datën 13.02.2018 nuk ka ndërmarr asnjë veprim përpara i përket paraqitjes së kërkesës për marrje të lejes të përkohshme ndërtimore për ndërtim të objektit të përkohshëm të paraparë e kontratë.

Në nenin 3 pika 2 të kësaj kontrate është përcaktuar se: "Afati i fillimit të investimeve konform projektit të aprovuar është jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës".

Poashtu, në nenin 8 të kontratës "Dështimi për të përmbushur kontratën" përkatësisht pikën 1 nënpika 1.1 është saktësuar se kontrata konsiderohet e dështuar nëse qiramarrësi dështon që të i përmbushë kushtet e kësaj kontrate, e që në rastin konkret një ndër kushtet për përmbushje të kontratës është fillimi i realizimit të investimeve jo më gjatë se 5 (pesë) ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.

Bazuar në faktin se qiramarrësi edhe pas 59 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës nuk ka bërë kërkesë për leje ndërtimore dhe brenda këtij afati nuk ka treguar interesim para organit kompetent të komunës për fillim të implementimit të kontratës për qiradhënie afatshkurtër me çka nuk i ka përmbushë obligimet e përcaktuara me kontratë përkatësisht ka dështuar për ta përmbushur kontratën siç precizohet në nenin 8 pika 1 nënpika 1.1, të së njëjtës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN

03 Nr./Bp 182 /18

Nr./Bp

Data / Datum 14.02.2018

VUŠITRAN - VUČITRAN




REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në Nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe Nenit 67 nën "f" dhe "g" të Statutit të Komunës 01Nr.58/11 të datës 28.04.2011, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, merr këtë:


**VENDIM
PËR FORMIM TË KOMISIONIT**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për plotësimin e pyetësorit për vetëvlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë përbërje :
 - 1.1 Lutfi Gërguri , kryesues
 - 1.2 Abit Abiti , anëtar
 - 1.3 Bislim Dushi, anëtar
 - 1.4 Haki Maloku , anëtar
 - 1.5 Sedat Rashica , anëtar
 - 1.6 Saranda Cakaj , anëtare
 - 1.7 Liridon Lahu , anëtar
 - 1.8 Idriz Muzaqi , anëtar
2. Komisioni në fjalë ka për detyrë të ofroj informata mbi aktivitetet në Komunës, duke plotësuar pyetësorin për vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim të avancimit dhe eliminimit të të metave me anë të vetëvlerësimit. Komentet duhet të shprehin gjendjen reale në Komunë.
3. Komisioni për punën e tij duhet ti raportoj Kryetarit të Komunës.
4. Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit dhe arkivit të sekretarisë



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesë e faturës me nr.0012276 të datës 07.02.2018 në shumë prej 34.00€ për shpenzimet e krijuar në B.I Ajshen Munishi- Vushtri, drekë me rastin e vizitës së delegacionit nga Vaxjo –Suedi dhe përfaqësues nga Komuna.
2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Zyrës Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUČITRË

QZ Nr. / Nr. 186/18

Datar / Datum 15.02.2018

VUSHTRRI - VUČITRË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesë e faturës me nr.0049797 të datës 07.02.2018 në shumë prej 195.00€(njëqindnëntëdhjetepesë euro) për shpenzimet e krijuar në DPH. Restorant "Qamera"- Vushtri, drekë me 5 zyrtar të delegacionit nga Vaxjo –Suedi dhe 8 zyrtar nga stafi i Kryetarit.
2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Zyrës Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRIN

02 Nr. / Nr. 187/18

Nr. / Datum 15.02.2018

VUSHTRRI - VUČITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67, "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e faturave me nr.020618012-1 datës 06.02.2018 në shumë prej 52.10€ dhe nr.020718001-1 datë 07.02.2018 në shumë prej 6.10€ për shpenzimet e krijuar në REVOLUTION N.T.P - Vushtrri, drekë me rastin e vizitës së delegacionit nga Vaxjo –Suedi dhe përfaqësues nga Komuna.
2. Pagesa të bëhet në llogarinë bankare të paraqitur në faturë, nga buxheti i Zyrës Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është fatura dhe kuponi fiskal i bashkangjitur në shtojcë.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
6. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRË

02 Nr. / Nr. 237 / 18

Nr. i Reg. / Nr. i

Data: / Datum: 16.02.2018

VUSHTRRI - VUÇITRË



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për pranim të laptopëve të ish zyrtarëve të komunës të mandatit të kaluar 2013/2017 të cilët nuk janë zgjedhur në mandatin e ri 2017/2021, në këtë përbërje:
 - Liridon Lahu, kryesues i komisionit
 - Skender Oshlani, anëtar
 - Idriz Ismajli anëtar
2. Komisioni në fjalë do të bëjë pranimin e laptopëve me të gjitha pajisjet tjera përcjellëse si dhe konstatoi gjendjen e tyre fizike – funksionale dhe në bashkëpunim me zyrtaren për regjistrim të pasurisë do të zbatoi procedurat ligjore me rastin e kthimit të laptopëve. Pranimi i këtij inventari bëhet në ditët e punës nga ora 8:30-11:30 dhe 13:30-15:30.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi iu dërgohet: anëtarëve të komisionit, zyrtares për regjistrim të pasurisë jo financiare të komunës dhe arkivit të sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafet Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 5, "d" të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Kosovës, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.08/2014 dhe nenin 67, "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Arsim 10 nr.128/18, dt. 21.02.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

1. Formohet komisioni për zgjedhës për intervistim, në Drejtorinë e Arsimit, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Z. Ardian Jashari**, Drejtor i SHMU, "Liria" Stroc,
 - 1.2 **Z. Shyqyri Bunjaku**, Drejtor i SHFMU "Mustafë Venhari,
 - 1.3 _____, Përfaqësuesi i MASHT-it.
2. Komisioni në fjalë ka për detyrë të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilët kanë aplikuar për pozitën: zv.drejtor në SHMU-2-Vushtri, në bazë të konkursit 02Nr.152/18, të datës 02.02.2018.
3. Komisioni, pas përfundimit të intervistimit do të përpilojë ranglistën sipas pikëve dhe ia rekomandon Kryetarit të Komunës zgjedhjen e kandidatit për pozitën e cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi ju dërgohet: Drejtorit për Arsim, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
Uz. Nr. / Uz.	259 / 18
Nr. Isp. / Br. st.	
Data / Datum	23.02.2018
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Sektori i gjendjes civile, Qendra për shërbim me qytetarë dhe Arka e komunës obligohen që të iu ofrojnë shërbime qytetarëve nga ora 8:30 deri në ora 16:00. Këto shërbime duhet të ofrohen gjithashtu edhe nga ora 12:00 deri 13:00.
2. Drejtorët e drejtorive të zyrtarëve që punojnë në këta sektorë duhet të organizojnë përshtatjen e orarit të punës në pajtim me të cekurat në pikën paraprake të këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
4. Vendimi i dërgohet: Drejtorit të Drejtorisë për Administratë, Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITAN

02 No. / Dv. 260 / 18

Nr. i Sq. / Dc. sh. - 02 -

Data: / Data: 26.02.2018

VUSHTRRI - VUČITAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Auditimin e Brendshëm dhe neni 3 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT NË KOMUNËN E VUSHTRRIË

1. Me këtë vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Vushtrrisë, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Albert Gashi**, kryesues
 - 1.2 **Rexhep Görguri**, anëtar
 - 1.3 **Ragbete Krasniqi**, anëtar
2. Mandati i Komitetit të Auditimit është 3 vjet nga dita e emërimit.
3. Komiteti, detyrat e tij do të i kryej konform dispozitave të Ligjit për Auditimin e Brendshëm dhe Udhëzimit Administrativ për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e Sektorit Publik.
4. Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës është sekretar i Komitetit të Auditimit i cili do të ndjek të gjitha takimet e Komitetit.
5. Komiteti i Auditimit duhet të mbledhet së paku 4 herë në vit, por Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje shtesë sipas nevojës.
6. Për çdo takim të Komitetit të Auditimit, sekretari mban procesverbalin dhe shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet e diskutuara. Procesverbalet mbahen në NJAB në pajtim me dispozitat ligjore apo nënligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje.
7. Komiteti i Auditimit përgatitë Raportin vjetorë për menaxhmentin e lartë të subjektit të sektorit publik.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 747/17, datë 19.06.2017
9. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
10. Vendimi i dërgohet: secilit anëtarë të Komitetit të Auditimit, Drejtorit të NJAB dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIŠË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr. / Be 265/18

Nr. i fq. / Be. et _____

Data: / Datum 27.02.2018

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të kërkesës së Zyrtares për Barazi gjinore në Vushtrri dt. 21.02.2018, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës në shumë deri në 1,000.00 € (njëmijë euro) për shpenzime që do të krijohen (udhëtimi me autobus dhe drekë) për zyrtare të komunës me rastin e shënimit të "8 marsit" – Ditës Ndërkombëtare të Gruas. Shënimi i kësaj date të bëhet në njërin nga lokalet hotelierë në Kosovë.
2. Pagesa e mjeteve të bëhet nga buxheti i Zyrës për Barazi Gjinore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet: Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Sekretarisë.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri